

Vendimi nr.297 datë 11.11.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Genti Ibrahimi, Anëtar

në datën 11.11.2025 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 13 (I) 2025 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **INDRIT CIRO**, përfaqësuar nga avokat Saimir Vishaj, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 12-2022-1913 (164), datë 13.12.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; nr. 1184 (30-2023-3832), datë 11.07.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2025-517, datë 01.04.2025 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 31, 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 50, pika 4, 51/a, pika 1, shkronja “b”, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë (*prokuroria*), mbi bazën e materialeve të referuara nga Policia Gjyqësore e Komisariatit të Policisë Kavajë, në datën 08.08.2021 ka regjistruar kallëzimin penal nr. 534, për veprën penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, të parashikuar nga neni 100, paragrafi 1, i Kodit Penal (KP), ndaj kërkuesit Indrit Ciro, i cili ka abuzuar seksualisht ndaj të miturit O.H., i cili ka moshën 12 vjeç dhe vuan nga çrregullime të spektrit autik.

2. Në përfundim të hetimeve paraprake, prokuroria ka paraqitur kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. 304/2021 në ngarkim të kërkuesit për veprën penale të parashikuar nga neni 101, paragrafi 1, i KP-së, në dëm të viktimës së mitur O.H.

3. Në seancën paraprake kërkuesi nëpërmjet mbrojtjes së tij ka kërkuar të gjykohet me ritin e gjykimit të shkurtuar, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata, pasi provat në ngarkim të kërkuesit ishin të plota dhe çështja penale mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet, ndërsa nga i pandehuri nuk u paraqitën pretendime për pavlefshmëri, papërdorshmëri ose marrje të provave të reja, por edhe ajo nuk konstatoi rrethana të tilla.

4. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 12-2022-1913 (164), datë 13.12.2022, ka vendosur deklarinin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur”, bazuar në nenin 100, paragrafi 1, të KP-së dhe dënimin e tij me 15 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) kërkuesit i është ulur 1/3-ta e dënimit si rrjedhojë e aplikimit të gjykimit të shkurtuar, duke u dënuar përfundimisht me 10 vjet burgim. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi, i cili ka kërkuar deklarinin të pafajshëm.

5. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 1184 (30-2023-3832), datë 11.07.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se ai është një vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj. Kjo gjykatë e ka vlerësuar të drejtë masën e dënimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, si një masë e përshtatshme dhe në përputhje me veçoritë e veprës penale konkrete, si dhe me rrethanat në të cilat vepra penale është kryer. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi nëpërmjet mbrojtësve të tij.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin 00-2025-517, datë 01.04.2025, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmban asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

7. Në datën 15.08.2025 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 19.09.2025.

II

Pretendimet e kërkuetit

8. **Kërkuesi**, në mbështetje të kërkesës së tij, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtuar cenimin *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë është bërë në dhomën e këshillimit dhe çështja është shqyrtuar në një kohë relativisht të shkurtër krahasuar me çështjet e tjera të regjistruara përpara çështjes së kërkuetit.

8.1.2. *Parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejt dhe në mënyrë objektive provat e administruara prej saj, duke sjellë si pasojë zbatimin e gabuar të ligjit material penal për dënimin e kërkuetit. Vendimi i gjykatës së apelit ka një mungesë të theksuar të analizës ligjore, po ashtu edhe logjike në analizimin e fakteve dhe përcaktimin e fajësisë së kërkuetit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Arsyetimi i gjykatës së apelit, me të cilin kundërshtohen provat shkencore vetëm me një pohim të thjeshtë, është konsideruar i drejtë nga Gjykata e Lartë, duke cenuar parimin e sigurisë juridike dhe duke krijuar një precedent të rrezikshëm për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave procedurale të të pandehurit në procesin penal. Sipas kërkuetit, Gjykata e Lartë ka zhvilluar një proces formal, duke anashkaluar çdo pretendim ose shkak të paraqitur në rekurs. Sipas tij, ajo gjykatë ka arsyetuar mospranimin e rekursit vetëm me dy pohime, ndërkohë që në praktikën e saj të përditshme

shqyrton me qindra vendime, duke analizuar provat për efekt të zbatimit të drejtë të ligjit penal ose procedural.

8.1.3. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi prova e vetme për dënimin e kërkuarit është dëshmia e viktimës së veprës penale, provë e cila është keqinterpretuar nga gjykatat, duke shtrembëruar në mënyrë flagrante faktin penal. Gjykatat i kanë dhënë faktit një cilësim të gabuar, duke e paragjykuar çështjen objekt gjykimi dhe duke sjellë si pasojë që vendimi i dënimit të kërkuarit të jetë i pabazuar në ligj e prova.

8.1.4. *Parimit të barazisë përpara ligjit*, pasi Gjykata e Lartë në raste të mëparshme ka mbajtur qëndrim të ndryshëm, duke marrë në vlerësim provat në funksion të zbatimit të ligjit penal material ose procedural.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në verifikim të plotësisë të këtyre kriterëve, në rastin konkret Kolegji vëren se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, në vështirësi të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor objekt ankimi, për rrjedhojë justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuari i është drejtuar Gjykatës me

ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Për pasojë, ai nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

12. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit gjyqësor i dhënë në çështjen e tij është ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që mban datën 01.04.2025, i cili, sipas kërkuesit i është komunikuar nëpërmjet *e-mal*-it në datën 23.05.2025, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 19.09.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

13. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit, parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, si dhe të parimit të prezumimit të pafajësisë dhe barazisë përpara ligjit.

14. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit, kërkuesi ka pretenduar se shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë është bërë në dhomën e këshillimit dhe se çështja është shqyrtuar në një kohë relativisht të shkurtër krahasuar me çështjet e tjera të regjistruara përpara çështjes së tij.

15. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit për shkak të formës së gjyqimit të çështjes nga Gjykata e Lartë, Gjykata në jurisprudencën e saj ka mbajtur qëndrimin se vlerësimi nëse çështja duhet të shqyrtohet në dhomën e këshillimit ose në seancë publike u përket vetë kolegeve të Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 38, datë 22.02.2023; nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*), në këto kushte shqyrtimi paraprak i rekursit të kërkuesit nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit është bërë sipas formës së gjyqimit të përcaktuar nga ligji. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar. Në lidhje me pretendimin se çështja në Gjykatën e Lartë është shqyrtuar në një kohë relativisht të shkurtër krahasuar me çështjet e tjera të regjistruara përpara çështjes së kërkuesit, duke pasur parasysh që Gjykata e Lartë në vendimmarrjen e saj ka arsyetuar se shqyrtimi me përparësi i kësaj çështjeje është bërë në referim të nenit 17, pika 2, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, që parashikon se çdo organ kompetent shqyrton në mënyrë të shpejtë dhe brenda afateve të caktuara në këtë kod çështjet me të mitur viktimë, Kolegji vlerëson se ky pretendim nuk është ngritur në nivel kushtetues.

16. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi, sipas tij, prova e vetme për dënimin e tij është dëshmia e viktimës së veprës penale, provë e cila është keqinterpretuar nga gjykatat, duke shtrembëruar në mënyrë flagrante faktin penal. Gjykatat i kanë dhënë faktit një cilësim të gabuar, duke e paragjykuar çështjen objekt gjykimi dhe duke sjellë si pasojë që vendimi i dënimit të kërkuesit të jetë i pabazuar në ligj e prova. Kolegji vëren se Gjykata në mënyrë konstante ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë, të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar mbi këtë standard, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuesit ka të bëjë me çështje të vlerësimit të provave dhe të interpretimit e zbatimit të ligjit në raport me rrethanat e çështjes konkrete, që janë objekt i veprimtarisë së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk përfshihet në juridiksionin e Gjykatës, për rrjedhojë ky pretendim i kërkuesit nuk është ngritur në nivel kushtetues.

17. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga ai i mbajtur më parë në çështje të ngjashme, duke marrë në vlerësim provat në funksion të zbatimit të ligjit penal material ose procedural. Gjykata në jurisprudencën e saj, kur janë ngritur pretendime në lidhje me cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit për mënyrën sesi gjykatat kanë vendosur në raste të ngjashme, ka theksuar se vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet rast pas rasti, duke iu referuar edhe rastit konkret. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë *apriori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në vështrim

të këtyre standardeve, Kolegji vlerëson se jo vetëm argumentet e paraqitura prej kërkuesit janë të përgjithshme, por edhe se Gjykata e Lartë në vendimmarrjen e saj nuk rezulton të ketë vendosur në mënyrë të ndryshme me ndonjë vendim unifikues a njësues të praktikës gjyqësore. Për rrjedhojë, fakti që Kolegji Penal i asaj gjykate mund të ketë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, nuk përbën argument që mund të mbështesë pretendimin për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor nga pikëpamja kushtetuese, ndaj edhe ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

18. Për sa i takon pretendimit tjetër të kërkuesit, që ka të bëjë me cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit, duke qenë se është me natyrë kushtetuese, *prima facie* përfshihet në kompetencën e Gjykatës dhe do të analizohet në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

19. Kërkuesi ka pretenduar se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar drejt dhe në mënyrë objektive provat e administruara prej saj, duke sjellë si pasojë zbatimin e gabuar të ligjit material penal për dënimin e kërkuesit. Vendimi i gjykatës së apelit ka një mungesë të theksuar të analizës ligjore, po ashtu edhe logjike në analizimin e fakteve dhe përcaktimin e fajësisë së kërkuesit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Arsyetimi i gjykatës së apelit, me të cilin kundërshtohen provat shkencore vetëm me një pohim të thjeshtë, është konsideruar i drejtë nga Gjykata e Lartë, duke cenuar parimin e sigurisë juridike dhe duke krijuar një precedent të rrezikshëm për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave procedurale të të pandehurit në procesin penal. Sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë ka zhvilluar një proces formal, duke anashkaluar çdo pretendim ose shkak të paraqitur në rekurs. Sipas tij, ajo gjykatë ka arsyetuar mospranimin e rekursit vetëm me dy pohime, ndërkohë që në praktikën e saj të përditshme shqyrton me qindra vendime, duke analizuar provat për efekt të zbatimit të drejtë të ligjit penal ose procedural.

20. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të

tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 70, datë 15.10.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjithashtu, Gjykata është shprehur se interpretimi i ligjit është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 1, datë 20.01.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë interpretimi i ligjit i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 62, datë 23.09.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 14, datë 07.03.2024; nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji konstaton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, pasi ka bërë një analizë të veprës penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur”, ka vlerësuar se i pandehuri me veprime të drejtpërdrejta dhe të vullnetshme ka konsumuar nga ana objektive figurën e kësaj vepre penale. Për përcaktimin e fajësisë kjo gjykatë është shprehur se referuar natyrës së veprës së kryer, por njëkohësisht edhe veprimeve konkrete të të pandehurit, që vepra penale të konsiderohet e kryer nuk është e domosdoshme që të jetë përdorur dhunë, por mjafton mosha e mitur nën 14 vjeç, çka rezulton në rastin konkret. Po ashtu, edhe mungesa e provave biologjike, të cilat evidentohen edhe nga mbrojtja si shkak për pafajësi, konsiderohen të pambështetura nga gjykata. Sipas gjykatës, këto përfundime të akteve biologjike lidhen me mungesën e dëmtimeve dhe përdorimit të forcës, të cilat nuk nënkuptojnë se këto marrëdhënie nuk janë kryer. Referuar thënieve të të atit të viktimës se i mituri është larë nga nëna e tij menjëherë pasi ka ardhur në shtëpi dhe kallëzimi është bërë ditën e nesërme, janë faktorë që ndikojnë në përfundimet e aktit të ekspertimit dhe në mospasjen e gjurmëve. Po sipas gjykatës,

provat e tjera të administruara, si deklaratimet e viktimës, procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes, procesverbali i deklaratimit të shtetasit L.H., procesverbali i deklaratimit të të atit të viktimës, si dhe akti i ekspertimit psikologjik prej të cilit faktohen thëniet e të miturit për abuzim seksual të pësuar prej tij janë prova të mjaftueshme që provojnë se është kryer vepra penale për të cilën akuzohet kërkuesi. Për sa i përket llojit të masës së dënimit kjo gjykatë ka vlerësuar se merr në konsideratë jo vetëm faktin se viktimja është i mitur, por edhe situatën karakteristike të brishtësisë të të miturit edhe për shkak të gjendjes shëndetësore të tij, pasi rezulton të vuajë çrregullime të spektrit të autizmit, ndaj në përfundim ka vlerësuar se janë kushtet që të aplikohet masa maksimale e dënimit e parashikuar nga neni 100, paragrafi 1, i KP-së (*shih faqet 6-7 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë*).

23. Gjykata e apelit, në vijim, e ka vlerësuar të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me fajësinë e kërkuesit, pasi është provuar jashtë çdo dyshimi se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Po kështu, sipas gjykatës së apelit, nga tërësia e provave të administruara në dosjen gjyqësore, të përshkruara dhe të analizuara me hollësi nga gjykata e shkallës së parë dhe duke u çmuar ato mbi bazën e rregullave të vërtetësisë së tyre, sikurse dhe akteksptimi psikologjik, pavarësisht mohimit të veprimeve të të pandehurit ndaj të miturit, faktojnë deklaratimin e të miturit për abuzim seksual të pësuar prej tij. Sipas kësaj gjykate, pretendimet e mbrojtjes se provat e administruara për këtë çështje nuk provojnë akuzën në ngarkim të të pandehurit, duke pretenduar se prokurori duhet të thellonte hetimet në lidhje me këtë çështje mbështetur kryesisht mbi faktin se i mituri vuan nga çrregullime të spektrit autik, kjo e fundit vëren se vetë i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar, pasi ka vlerësuar se çështja ndaj tij mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet dhe nuk ka pretenduar të merren prova të tjera. Ndërsa për sa i përket vërtetësisë së akteve të ekspertimit biologjik dhe mjeko-ligjor, gjykata e apelit, sikundër dhe ajo e shkallës së parë, i ka çmuar ato në harmoni edhe me provat e tjera dhe arsyet e parashtruara nga i pandehuri nuk e zbehin provueshmërinë e akuzës. Në këtë mënyrë nuk qëndrojnë pretendimet e të pandehurit, qoftë për pafajësi se nuk provohet të ketë kryer veprën penale, qoftë për ndryshim të kualifikimit juridik të veprës penale, pasi akuza e ngritur ndaj tij provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, duke plotësuar elementet juridike për të pasur përgjegjësi penale për këtë vepër penale. Në lidhje me masën e dënimit kjo gjykatë vlerëson se është një masë e përshtatshme për të pandehurin në përputhje me veçoritë e tij dhe të veprës penale konkrete, si edhe me rrethanat në të cilat vepra penale është kryer, duke mbajtur parasysh edhe

parimin se ashpërsia e një penaliteti për një vepër penale të kryer duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale me ashpërsinë e veprës penale (*shih faqet 16-17 të vendimit të Gjykatës së Apelit*).

24. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në shqyrtimin e rekursit, ka vlerësuar se gjykatat e faktit kanë arsyetuar mjaftueshëm vendimmarrjen e tyre, duke analizuar provat në raport me ligjin material penal dhe se për pretendimet e kërkuarit që lidhen me mënyrën e vlerësimit të provave, ai Kolegj ka rikonfirmuar qëndrimin se pretendimet që lidhen me mënyrën e vlerësimit të fakteve dhe provave dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të asaj gjykate. Edhe për pretendimin e kërkuarit për individualizimin e dënimit, pasi gjykatat nuk kanë mbajtur në konsideratë dispozitat e KP-së, ai kolegj konstaton se është marrë në shqyrtim nga gjykata e apelit, e cila e ka gjetur të drejtë masën e dënimit të caktuar nga gjykata e shkallës së parë. Po ashtu, edhe pretendimi për mosarsyetimin e vendimit nga gjykata e apelit është gjetur i pabazuar nga Gjykata e Lartë, pasi në rastet kur gjykata e apelit e lë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, arsyetimi edhe mund të jetë minimal ose i reduktuar, ndërsa kur ajo e ndryshon vendimin, është e detyruar të paraqesë dhe të shtjellojë në mënyrë të plotë argumentet ligjore, si pasojë e të cilave ka arritur në një vendimmarrje të ndryshme nga gjykata më e ulët. Në përfundim, Kolegji Penal ka arsyetuar se nuk konstatohet që nga gjykata e apelit të ketë mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural penal me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore apo me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, apo që vendimi të jetë në kundërshtim me praktikën e tij ose të Kolegjeve të Bashkuara (*shih paragrafët 19-24 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

25. Për sa më lart, Kolegji vëren se për sa i përket arsyetimit të gjykatave të faktit për deklarinimin fajtor të kërkuarit për veprën penale të marrëdhënieve seksuale me të mitur, ato kanë pranuar se mungesa e provave biologjike nuk është e mjaftueshme për të konkluduar për pafajësinë e të pandehurit. Këto gjykata kanë vlerësuar se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri me veprimet e tij të drejta dhe të vullnetshme e ka kryer veprën penale në tërësinë e elementeve konstituive. Ky arsyetim është gjetur i bazuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka vlerësuar se gjykatat e faktit kanë arsyetuar mjaftueshëm vendimmarrjen e tyre, duke analizuar provat në raport me ligjin material penal. Nga analiza e vendimeve gjyqësore, Kolegji çmon se nuk evidentohen gabime ligjore ose faktike në vlerësimin e gjykatave, të tilla që të vënë në dyshim konkluzionin e tyre.

26. Po ashtu, edhe Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs nga kërkuesi. Në ushtrim të rolit të saj si gjykatë ligji, ajo ka verifikuar këto pretendime, duke arritur në përfundimin se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar drejt ligjin material dhe procedural. Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë plotëson të gjitha elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tij. Nga ana tjetër, për sa u përket pretendimeve të kërkuesit për mënyrën sesi gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet e çështjes dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre, në thelb, kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe të interpretimit e zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme dhe, si të tilla, nuk përfshihen në juridiksionin e kësaj Gjykate. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

27. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.